



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 280/3 Prot.

Tiranë, më 10.02.2021

VENDIM

Nr. 21, datë 10.02.2021

**PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN E PËRFUNDIMIT TË
PARAKOHSHËM TË MANDATIT TË ANËTARËVE TË SENATIT
PROF.DR. BARDHYL MISJA DHE PROF.ASOC. KUJTIM KAPEDANI**

Mbështetur në nenin 37, pika 5 të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, në pikën 5 gërma “d” dhe pikën 6 të nenit 19, si dhe në pikën 5 dhe 6 të nenit 61 të Statutit të UST-së; në zbatim të Vendimit të Rektorit Nr. 37, datë 09.02.2021 “Për zbatimin e masës disiplinore të propozuar nga Komisioni Ad-Hoc i Senatit Akademik të UST”, i ngritur me Vendimin e Senatit Nr. 12, datë 22.01.2021, Senati Akademik i UST në mbledhjen e tij të datës 10.02.2021

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen e Komisionit Ad-Hoc për shqyrtimin e përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarëve të Senatit, Prof.Dr. Bardhyl Misja dhe Prof.Asoc. Kujtim Kapedani si përfaqësues të FSHL në Senatin Akademik të UST.
2. Të miratojë përbërjen e këtij Komisioni si vijon:

- Prof.Asoc. Arben Kaçurri	Kryetar	(IKSHS)
- Prof.Dr. Adriatik Meta	Anëtar	(FSHL)
- Prof.Asoc. Bashkim Delia	Anëtar	(FVFR)
3. Objekt i veprimtarisë së Komisionit Ad-Hoc, sipas miratimit nga Senati Akademik dhe pikës 6 të nenit 19 të Statutit të Universitetit të Sporteve, do të jetë shqyrtimi i rasteve të përfundimit para kohe të mandatit të anëtarëve të Senatit Akademik, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Komisioni Ad Hoc, brenda datës 18.02.2021 t'i njoftojë me shkrim Senatit Akademik për përfundimet dhe propozimet e konkludura.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA

